

Deri te:

Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës, me nr. 19-162/2 nga mbledhja e mbajtur në datën 01.07.2020 për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull “Krahasimet e basketbollistëve junior të super ligës dhe ligës unike të Kosovës në parametrat antropometrike dhe në aftësitë motorike e funksionale” të kandidatit Ma. Bujar Begu. Komisioni në përbërje: Prof Dr. Hynor Kica - kryetar, Prof. Dr. Fadil Rexhepi - anëtar, Prof. Dr. Haki Ismaili - anëtar, Prof. Dr. Shpresa Memishi - anëtar, dhe Prof. Dr. Metin Dalip - mentor.

Këshilli Mësimor Shkencorë paraqet këtë:

RAPORT

Për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Bujar Begu ka lindur në Mitrovicë në vitin 16.06.1982, ku edhe shkollën fillore dhe atë të mesme i ka përfunduar në qytetin e lindjes. Ndërsa fakultetin e kulturës fizike dhe sportive 3 vjeçar ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës në vitin 2005. Më 21.03.2012 mbaroi studimet bachelor me 240 ETCS në kolegjin “Universi” po të njejtin kolegji vazhdoi studimet posdiplomike (master) i cili diplomoi në lëmin e basketbollit.

Përvoja personale:

Që nga fëmijëria është marrë me basketboll ka luajtur si junior në kb. “Trepça” ndërsa si senior në kb. “Mitrovica” në ligën e parë të Kosovës. Në vitin 2003 fillon karrierën e trajnerit në shkollën e basketbollit për gjeneratat e reja “Arda Rei” në Prishtinë dhe punon deri në vitin 2005. Që nga viti 2005 - 2010 ka punuar si profesor i ed. fizike dhe sportive në shkollën e mesme të lartë “Hasan Prishtina” Mitrovicë. Prej vitit 2014 e tutje përzgjedhet si drejtor në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Jusuf Rexha” Koshtovë në Komunën e Mitrovicës.

Në vitin 2008 - 2009 nga Federata e Basketbollit të Kosovës përzgjedhet si trajner i reprezentacionit të Kosovës në kategorinë U-18. Ishte përzgjedhur si trajner në shumë kampe të basketbollit të organizuara nga FBK-ja me trajner të huaj.

Në vitin 2009-2010 bëhet trajner në kb. Mitrovica në ligën e parë dhe solli rezultate mjaft të mira duke e inkuadruar ekipin një rang më të lartë në super ligën Kosovës, dhe njëkohësisht ka udhëhequr edhe ekipin e juniorëve të kb. Mitrovica. Me suksesin e treguar në vitin 2010 përzgjedhet trajner i seniorëve në klubin e basketbollit "Trepça".

Në vitin 2011-2013 ishte anëtar i këshillit profesional pranë Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Më datë 24.04.2008 nga Kolegji "Universi" emërohet asistent i prof. dr. Masar Nixha në lëndën e basketbollit deri në vitin 2014. Më pastaj më datë 01.10.2014 e tutje nga i njëjti kolegji emërohet si ligjerues në lëndën e basketbollit.

Në kolegjin e kulturës fizike sport dhe rekreacion "Universi" ishte mentor i shumë punimeve të diplomave poashtu edhe anëtar i komisioneve të temave të diplomave bachelor dhe master.

Është anëtar në Qendrën për Kërkime, Studime në Edukimin Fizikë, Sport dhe Shëndet (CRSPES) dhe momentalisth udhëheqës i shkollës së basketbollit "Mitrobasket" në Mitrovicë.

Në vitin 2015 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin e Kulturës Fizike - drejtimi kineziologji.

Më poshtë po i paraqesim punimet shkencore të publikuara në revistat kombëtare dhe ndërkombëtare.

- 1. Arta Ibrani, Abedin Bahtiri, Fadil Mahmuti, Jeton Havolli, Bujar Begu, Sabri Makolli (2015).** Determination of Foot Derfomities Using Method of Footprint – Plantography. ISSN: 1857 – 9310. (2). pp. 5 - 10.
- 2. Bujar Begu, Artan Kryeziu (2017).** 12-Week Effect of Plyometric Program in Ages 17-18 Years in Basketball. “Sport and Health “Universitetin Shtetëror të Tetovës. ISSN: 1857 - 9310. (4). pp. 22 - 29.
- 3. Bujar Begu, Artan Kryeziu, Fadil Nika (2018).** The Influence of Athropometric and motor Variables in Test of situational Accuracy to Cadet Players of Basketball game. “Sport and Health” Universiteti Shtetëror i Tetovës. ISSN: 1857 - 9310. ISSN 2545 – 4978 (online). UDC: 796:613.7, pp. 55 - 61.
- 4. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Isa Asllani (2019),** Aerobic – anaerobic performance of basketballplayers according to U-18 game position. 6th International Balkan Conference in Sport Science. 6. 15.
- 5. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Enver Tahiraj, Isa Asllani (2018),** The effect of physical education curriculum between initial and final measurement in the body mass index (BMI) at age 13, 14 and 15 years female. 15th International Scientific Conference on Transformation Process in Sport. Montenegrin Sport Academy: Budva - Montenegro. 15. 69.
- 6. Bujar Begu, Artan Kryeziu, Jeton Havolli (2018).** Latent Structure of the Morphological Characteristics and Motor Basic Abilities and Situational to Basketball Players 14-15 years. “Sport Mont” 16 (6) 69-74. ISSN 1451-7485, eISSN 2337-0351, (6), pp. 69 - 74.
- 7. Bujar Begu, Artan Kryeziu, Abedin Bahtiri (2018).** The Influence of Anthropometric variables in Agility Abilities of Young Basketball Players. “Sport Science” Bosnia & Herzegovina ISSN: 1840 - 3670. (11). fq. 57 - 60.
- 8. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Isa Asllani (2018).** Structure of Morphological Characteristics of Young Basketball Players. “Sport Science” Bosne. ISSN: 1840 - 3670 (11). fq. 61-63.

9. **Artan Kryeziu, Bujar Begu, Enver Tahiraj, Isa Asllani (2018)**. Comparison of Body Mass Index Between 16 and 17 years of age in Basketball Players Game. International Journal of Sport Science and Health, Sport and Health. Vol. 5 No. 9 - 10.
10. **Artan Kryeziu, Bujar Begu, Fadil Nika (2018)**, The effect of a 30-day Plyometric Training Programme on increasing of Explosive Strength and Agility in basketball players. International Scientific Journal of Kinesiology, Sport Science. 11 (1). 107- 113.
11. **Jeton Havolli, Abedin Bahtiri, Bujar Begu, Arta Ibrani, Sabri Makolli (2017)**, Monitoring of Some Strength Parameters in Handball. "Sport Mont" ISSN 1451-7485, eISSN 2337-0351. (11). fq. 37-39.
12. **Artan Kryeziu, Bujar Begu, Isa Asllani, Astri Iseni (2019)**, Effects of the 4 week Plyometric Training Program on Explosive Strength and Agility for Basketball Players. Turkish Journal of Kinesiology. DOI: 10.31459/turkjkin.553453. 5 (3) 110-116.
13. **Bujar Begu, Metin Dalip, Jeton Havolli, Sherif Ilazi (2020)**, Differences Between Basketball Players of Super and Unique League in Situational and Motor Abilities at Kosovo Juniors. Konferenca shkencore ndërkombëtare "Sport, Physical Activity and Health". Sport Mont.
14. **Jeton Havolli, Primoz Pori, Sami Sermahaj, Bujar Begu (2020)**, Throwing Speed of Handball According to the Playing Position. Konferenca shkencore ndërkombëtare "Sport, Physical Activity and Health". Sport Mont.

Në projektin e temës së disertacionit të doktoraturës me titull: **Krahasimet e basketbollistëve junior të super ligës dhe ligës unike të Kosovës parametrat antropometrike dhe në aftësitë motorike e funksionale** ka për qëllim analizimin dhe vërtetimin e dallimeve ndërmjet këtyre të dy ligave të basketbollistëve junior të karakteristikave antropometrike, motorike bazike, motorike situacionale dhe aftësive funksionale aerobe - anaerobe.

Në **Hyrje** të këtij punimi ka sqaruar se matjet dhe testimet të standardizuara dhe të organizuara është një pjesë shumë e rëndësishme dhe e nevojshme për të gjitha sportet por edhe në sportin e basketbollit që të jetë pasqyrë të gjendjës aktuale të kësaj moshe, por gjithashtu të paraqitet një vizion në të cilin drejtim duhet shkon procesi i stërvitjeve.

Në mungesë të hulumtimeve të duhura të kësaj moshe në Kosovë autori në fjalë ka përzgjedhur popullatën e të rinjëve të moshës nën 18 vjeçar të meshkujve të cilët mund të inkorporohen edhe në ekipet e seniorëve si në stërvitje ashtu edhe në lojë.

Pra ky studim synon të analizoj, dhe të ipen të dhëna në karakteristikat antropometrike, motorike dhe funksionale të basketbollistëve junior të Republikës së Kosovës.

Në **kapitullin e parë** - fillimisht janë paraqitur domethënjet e termeve të cilat e përmenden ose trajtohen në këtë punim, më pastaj bëhet definimi i nocioneve të parametrave antropometrike, motorike dhe atyre funksionale, po në këtë kapitull janë paraqitur hulumtimet e deritanishme të punimeve shkencore kryesisht të autorëve të huaj të këtyre viteve të fundit në ato hapësira të cilat janë trajtuar në këtë punim të karakteristikave antropometrike, aftësive motorike bazike, motorike situacionale, dhe aftësive funksionale. Në **kapitullin e dytë** - është përfshirë problemi i hulumtimit i cili është i rëndësishëm së shumëfishtë, e sidomos kur bëhet fjalë për këtë moshë në 18 vjeçar, në lëndën e hulumtimit bëhet njohja e këtyre karakteristikave trupore dhe aftësive motorike e funksionale në sportin e basketbollit të cilët janë një tregues të rezultateve të lojës së basketbollit, në qëllimin e hulumtimit bëhet analizimi dhe vërtetimi i dallimeve ndërmjet këtyre të dy ligave të basketbollistëve junior në parametrat antropometrike, dhe në aftësitë motorike e funksionale, në hipotezat e hulumtimit janë parashtruar shtatë hipoteza, ndërsa në metodologjin e hulumtimit është përfshirë mostra e entiteteve prej 120 lojtarëve junior aktiv të cilët garojnë në kampionatin pranë Federatës së basketbollit të Kosovës të ndarë në dy liga: Super liga me gjashtë ekipe të cilat janë Kb. Keresan Prishtina nga Prishtina, kb. M-Junior nga Prishtina, kb. Prishtina e re, kb. Trepça nga Mitrovica, kb. Borea nga Peja dhe kb. Vushtrriabasket nga Vushtrria të përfaqësuar me 60 lojtar të moshës mesatarisht 17.25 vjeçar me përvojë në sportin e basketbollit 4.03 vite mesatarisht ndërsa liga unike me pesë ekipe të cilat janë: Kb. Z.Mobile nga Prishtina, kb. Penza nga Peja, kb. Rahoveci nga Rahoveci, kb. Istogu nga Istogu dhe kb. Lipjani nga Lipjani gjithashtu 60 lojtar të moshës 16.93 vjeçar dhe me përvojë në basketboll mesatarisht 4.28 vite.

Në këtë hulumtim përfshihen gjithsej 50 variabla. Në hapësirën antropometrike u përdorën 21 variabla, ndërsa hapësira motorike bazike 12 variabla, motorika situacionale 5 variabla kurse hapësira funksionale aerobe 8 variabla ndërsa anaerobe 4 variabla. Autori i

përshkruan të gjitha variablat veç e veç të cilat janë të standardizuara dhe të aplikuara më herët nga autorët e huaj dhe vendor.

Për sa i përket paisjeve për matje dhe testimeve për këta basketbollistë përveç mjeteve të tjera bazike janë përdorë edhe 3 instrumente më të sofistikuar si: peshorja e modelit (*Tanita BC-545N*), kohëmatësi dixhital (Microgate) të prodhimit “Witty Timer Menager” të versionit 1.4 dhe aparati për matjen e shtypjes së gjakut të modelit (Omron). Ndërsa me ndihmën e programit SPSS versioni 22.0 janë përpunuar të dhënat statistikore: Mean (*Mesi aritmetik*), Min. (*Rezultati minimal*), Max. (*Rezultati maksimal*), Std. Deviation (*Devijimi standard*), T-Testi (*Dallimet e mesatareve aritmetike në mes dy variablave*), Analiza kanonike diskriminative (*Diferencimin ndërmjet dy e më shumë grupeve në numër të madh të variablave manifeste*). Korelacioni sipas pearsonit (*Ndërlidhja ndërmjet dy e më shumë variablave*), Analiza faktoriale (*Vërtetimi e strukturës latente të hapësirave të hulumtuara*), Analiza regressive (*Ndikimi i variablave prediktore të hapësirës latente në variablat kritere të hapësirës manifeste*).

Në **kapitullin e tretë** janë paraqitur interpretimet rezultateve deskriptive (themelore) të hapësirës antropometrike, motorike bazike e situacionale dhe gjithashtu edhe atyre funksionale aerobe - anaerobe të krahasuara mesataret aritmetikore ndërmjet super ligës dhe ligës unike. Më pastaj bëhet krahasimi i mesatareve aritmetikore të tre ekipeve më të mira të super ligës dhe ligës unike në fund të edicionit 2018 - 2019 në hapësirat antropometrike, motorike dhe funksionale. Përmes procedurës statistikore T-test është bërë krahasimi i dy ligave të juniorëve në një variabël të hapësirave antropometrike, motorike dhe funksionale. Po ashtu me analizën kanonike diskriminative është analizuar në tre hapësirat veç e veç që i përmbajnë këto të dhëna: (F_{cn}) Funkzioni diskriminues, (λ) Rrënja karakteristike e barazimit, (R_c) Koeficienti i korelacionit kanonik, (λ) Lambda e Wilks-it² - kriteri për forcën diskriminuese të variablave, (X^2) Testi i Bartlett-it - teston rëndësinë statistike të ekuacionit diskriminues, (df) Shkallët e lirisë, (Sig) Niveli i rëndësisë së funksionit diskriminues. Gjithashtu autori në këtë kapitull ka përfshirë korelacionet ndërmjet variablave antropometrike, korelacionet ndërmjet variablave motorike bazike dhe motorike situacionale, korelacionet ndërmjet variablave funksionale aerobe - anaerobe, por gjithashtu edhe kroskorelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike bazike e situacionale, ndërmjet variablave antropometrike dhe variablave funksionale aerobe -

anaerobe dhe kroskorelacionet e variablave motorike bazike e situacionale ndërmjet variablave funksionale aerobe - anaerobe. Përmes analizës faktoriale janë paraqitur rrënjët kryesore karakteristike (LAMBDA) sikurse edhe kontributi parcial dhe kumulative të tyre për sqarimin e variabilitetit të përgjithshëm dhe sipas metodës së Hotelling-ut dhe kriterit GK (gutman-kaiser), janë ekstrahuar komponentët kryesore të variancës së përgjithshme të sistemit antropometrike, motorike bazike e situacionale dhe aftësive funksionale. Gjithashtu në këtë punim është aplikuar edhe analiza regresive për të vërtetuar ndikimin e variablave (faktorëve) prediktore të hapësirës latente antropometrike, motorike dhe funksionale (aerobe-anaerobe), dhe si kritere pesë variablave manifeste të motorikës situacionale.

Në **kapitullin e katërt** dhe i fundit është paraqitur diskutimi ku janë analizuar krahasimet ndërmjet basketbollistëve junior të super ligës dhe ligës unike gjithashtu janë krahasuar edhe me punimet të autorëve të huaj dhe vendor të shteteve të ndryshme në hapësirat antropometrike, motorike e situacionale dhe në aftësitë funksionale poashtu është diskutuar edhe në analizën faktoriale në tre hapësirat. Gjithashtu në këtë kapitull autori bën analizimin dhe vërtetimin e hipotezave duke u bazuar në rezultatet e këtij punimi shkencor, dhe si përfundim të këtij disertacioni në bazë të rezultateve të fituara autori bën një përmbledhje të tërë punimit me konkludime dhe rekomandime për hulumtuesit shkencore, trajnerë që merren me gjenerata të reja në sportin e basketbollit.

Përfundimi dhe propozimi nga komisioni

Punimi i disertacionit të doktoraturës me titull: **Krahasimet e basketbollistëve junior të super ligës dhe ligës unike të Kosovës në parametrat antropometrike, dhe në aftësitë motorike e funksionale** të kandidatit Ma. Bujar Begu sjellë një hulumtim shkencor në fushën e kineziologjisë pikërisht në sportin e basketbollit. Përmes analizave statistikore dhe rezultatet e fituara të këtij hulumtimi shkencor në lëmin e basketbollit kandidati paraqet punën hulumtuese të jashtëzakonshme dhe jep një kontribut shkencor të kësaj moshe nën 18 vjeçar të basketbollistëve duke hulumtuar strukturën antropologjike të kësaj gjenerate e cila është kryesore për të ardhmen e basketbollit dhe përmes krahasimeve ka treguar

gjendjen e tyre antropometrike, motorike dhe funksionale të këtyre basketbollistëve duke u bazuar edhe me basketbollistët nga rajoni dhe bota.

Në bazë të këtij raporti që është thënë lartë: Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: Krahasimet e basketbollistëve junior të super ligës dhe ligës unike të Kosovës në parametrat antropometrike, dhe në aftësitë motorike e funksionale të kandidatit Ma. Bujar Begu i cili konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson të gjitha kriteret të përcaktuara dhe i propozon Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës që të aprovojë këtë raport të vlerësimit e disertacionit të doktoraturës dhe të lejojë për mbrojtjen publike.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Hynor Kica - Kryetar 
2. Prof. Dr. Fadil Rexhepi - anëtar 
3. Prof. Dr. Haki Ismaili - anëtar 
4. Prof. Dr. Shpresa Memishi - anëtar 
5. Prof. Dr. Metin Dalip - Mentor 